

**VENDIM**  
**Nr.766, datë 24.9.2010**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR  
PËR KËSHILLIN E LARTË TË DREJTËSISË, PËR SHPENZIME KORENTE,  
NDËRMJET PROGRAMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Rishpërndarjen e fondeve brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, për shpenzime korente, ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Programit të planifikimit, menaxhimit dhe administrimit për vitin 2010, t’i shtohet fondi 3 400 000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë.

b) Programit të veprimtarisë mbikëqyrëse të KLD-së, për vitin 2010, t’i pakësohet fondi 3 400 000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë.

2. Ngarkohen Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**